


Tregtia e jashtme e mallrave

Shtator 2020

Tiranë, më 19 Tetor 2020: Në Shtator 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 25 mld lekë, duke u rritur me 1,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe 30,1 %, në krahasim me Gusht 2020. Importet e mallrave arritën vlerën 52 mld lekë, duke u rritur me 0,3 %, në krahasim me një vit më parë dhe 8,6 %, në krahasim me Gusht 2020. Deficiti tregtar i këtij muaji është 27 mld lekë, duke u ulur me 0,5 %, krahasuar me Shtator 2019 dhe 5,9 %, në krahasim me Gusht 2020.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave, Shtator 2020 (%)




Në nëntëmujorin e 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 195 mld lekë, duke u ulur me 13,6 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 429 mld lekë, duke u ulur me 10,9 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 234 mld lekë, duke u ulur me 8,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve prej 1,2 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +3,5 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,0 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +0,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar kryesisht grupi: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -5,3 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me -1,3 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shtator 2020




Eksportet, gjatë periudhës nëntëmuajore janë ulur me -13,6 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar kryesisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Tekstile dhe këpucë” me -6,7 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqim, pije, duhan” me +0,9 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 0,3 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,5 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,2 pikë përqindje “Tekstile dhe këpucë” me -1,0 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me -0,6 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shtator 2020



Si nëntëmujor, importet janë ulur me 10,9 %, krahasuar me nëntëmujorin e parë 2019. Grupet që kanë ndikuar kryesisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -2,5 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -2,0 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve nuk ka ndikuar pozitivisht asnjë grup.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Shtator 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shtator 2019 janë: Kosova (12,1 %), Greqia (25,9 %), dhe Franca (226,4 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (5,3 %), Spanja (34,9 %), dhe Mali i Zi (1,1 %).

Gjatë periudhës nëntëmuajore vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Gjermania (8,9 %), Serbia (7,0 %), dhe Franca (13,0 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (18,4 %), Kosova (20,7 %) dhe Spanja (16,2 %).

Në muajin Shtator 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Shtator 2019 janë: Italia (2,2 %), Kina (5,1 %) dhe Gjermania (8,1 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Turqia (14,2 %), Greqia (2,9 %) dhe Polonia (1,2 %).

Gjatë periudhës nëntë mujore, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Rusia (26,1 %), Maqedonia e Veriut (2,6 %) dhe Holanda (7,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (14,1 %), Turqia (2,8 %) dhe Greqia (8,3 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shtator 2020



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 63,3 %, të gjithë tregtisë. Në Shtator 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 57,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,2 %), Greqia (8,0 %), Turqia (6,9 %) dhe Gjermania (6,4 %).

Shkëmbimet tregtare, për nëntë mujorin e 2020, me vendet e BE zënë 63,0 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shtator 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 57,4 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,2 %), Greqia (7,7 %), Gjermania (7,1 %) dhe Turqia (6,9 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Shtator 2020

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,6	-28	49,2
	07 - 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	08 - 18	20	10,8	48	-2,3	-28	42,4
	09 - 18	26	8,9	51	-4,4	-25	51,4
	Janar – Shtator 18	232	15,3	467	3,1	-236	49,6
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	07 - 19	28	3,7	60	2,7	-32	46,4
	08 - 19	20	-1,8	52	7,1	-32	38,8
	09 - 19	25	-4,9	52	2,3	-27	47,8
	Janar – Shtator 19	225	-2,8	481	3,1	-256	46,8
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,8	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	07 - 20	25	-11,5	57	-5,0	-32	43,3
	08 - 20	19	-3,4	48	-6,7	-29	40,2
	09 - 20	25	1,2	52	0,3	-27	48,2
	Janar – Shtator 20	195	-13,6	429	-10,9	-234	45,4

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere, Shtator 2020 (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Shtator 2019	Shtator 2020	Jan. - Sht. 2019	Jan. - Sht. 2020	Shtator 2019	Shtator 2020	Jan. - Sht. 2019	Jan. - Sht. 2020
Vendet e BE-së	19.218	19.160	170.974	146.507	29.302	29.994	278.903	246.119
Austri	87	170	1.350	1.113	578	469	5.253	4.044
Gjermani	1.041	1.087	10.788	11.745	3.590	3.879	33.227	32.495
Greqi	1.087	1.368	9.550	9.300	4.961	4.819	42.142	38.639
Itali	12.420	11.760	109.357	89.245	12.927	13.216	122.662	105.360
Spanjë	2.270	1.478	14.984	12.561	692	731	8.359	6.928
Kroaci	69	107	788	1.174	536	493	5.204	4.785
Të tjera të BE-së	2.244	3.191	24.157	21.368	6.019	6.387	62.057	53.868
Mbretëri e Bashkuar	56	63	537	534	438	341	4.227	3.685
Kinë	644	190	4.813	3.390	4.516	4.744	44.339	37.860
Kosovë	2.449	2.746	22.628	17.936	761	751	5.902	5.883
Maqedonia e Veriut	740	896	6.278	6.186	758	836	6.364	6.529
Rusi	1	0	75	13	930	1.009	8.654	10.913
SHBA	209	292	2.970	2.288	981	638	7.980	6.561
Turqi	253	236	1.609	1.905	5.964	5.115	42.342	41.142
Ukrainë	5	13	120	325	147	379	2.414	3.228
Zvicër	74	33	633	551	934	511	11.095	7.532
Të tjera	1.291	1.614	14.481	14.952	7.456	8.035	69.089	59.203
Gjithsej	24.940	25.242	225.117	194.586	52.185	52.352	481.309	428.655

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave, Shtator 2020 (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shtator 2019	Shtator 2020	Jan. - Sht. 2019	Jan. - Sht. 2020	Shtator 2019	Shtator 2020	Jan. - Sht. 2019	Jan. - Sht. 2020
Gjithsej	24.940	25.242	225.117	194.586	52.185	52.352	481.309	428.655
Ushqime. pije. duhan	2.687	2.923	25.420	27.534	9.280	8.964	82.404	81.985
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	4.865	3.545	36.596	28.370	5.515	4.905	58.378	38.614
Produkte kimike dhe plastike	684	714	5.890	5.488	7.594	7.453	65.421	65.040
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	205	103	1.835	1.424	1.352	1.104	13.005	9.185
Prodhime druri dhe letre	808	784	7.042	6.113	2.243	2.259	19.210	17.348
Tekstile dhe këpucë	9.903	9.579	90.309	75.207	7.512	6.982	64.425	52.252
Materiale ndërtimi dhe metale	3.482	4.236	34.844	28.454	6.270	6.715	60.795	57.226
Makinieri. pajisje dhe pj. këmb.	1.613	2.493	16.517	15.827	10.562	11.872	99.945	90.541
Të tjera	694	866	6.665	6.169	1.858	2.097	17.727	16.465

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, Shtator 2020 (milione lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	109.357	89.245	22.628	17.936	14.984	12.561	10.788	11.745
Ushqim. pije duhan	6.108	6.466	2.724	2.804	947	937	1.199	1.283
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	4.474	890	5.479	3.034	12.079	10.724	806	861
Produkte kimike dhe plastike	1.555	1.469	1.574	1.604	47	84	53	40
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.530	1.235	5	5	159	71	10	21
Prodhime druri dhe letre	4.720	3.666	649	558	4	3	122	274
Tekstile dhe këpucë	70.321	56.702	77	82	1.583	590	5.667	6.480
Materiale ndërtimi dhe metale	10.296	8.799	10.280	8.140	154	106	1.233	854
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	7.534	7.488	548	550	6	26	1.123	1.391
Të tjera	2.821	2.531	1.291	1.160	4	20	575	541

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, Shtator 2020 (milione lekë)

	Itali		Turqi		Greqi		Kina	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	122.662	105.360	42.342	41.142	42.142	38.639	44.339	37.860
Ushqim. pije duhan	14.503	14.418	4.169	3.987	11.921	12.009	610	584
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	6.788	4.116	1.778	2.954	9.761	6.843	5	6
Produkte kimike dhe plastike	13.671	13.701	5.946	6.206	5.807	5.649	4.254	4.080
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	10.330	7.378	205	202	22	25	585	427
Prodhime druri dhe letre	5.032	4.239	2.547	2.129	2.628	2.637	773	613
Tekstile dhe këpucë	30.369	23.123	13.030	11.036	2.709	2.677	8.607	6.977
Materiale ndërtimi dhe metale	14.201	12.342	8.098	7.359	6.131	5.679	7.165	4.761
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	23.774	22.571	5.006	5.577	2.029	2.097	18.208	16.686
Të tjera	3.994	3.472	1.563	1.691	1.133	1.024	4.132	3.726

Metodologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri